

# Histori Suksesi

## "Puna e Njesisë Lëvizëse në fuqizimin e të rinjve për parandalimin e trafikimit në persona"

Në kuadër të muajit Tetor i shpallur si muaji Anti-trafik, Njësia Lëvizëse Tiranë dhe Shkodër e organizatës "Të Ndryshëm dhe Të Barabartë" së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtoritë Arsimore, Bashkitë Tiranë dhe Shkodër kanë realizuar një seri aktivitete duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit mbi trafikimin në persona si dhe promovimin e përpjekjeve për parandalimin e këtij fenomeni.

**"Ne të rriturit nxitojmë nganjëherë kur na kërkohet të përshkruajmë të rinjtë tonë. Shqipëria ka shumë të rinj plot jetë, me ide dhe të motivuar për ta bërë këtë vend më të mirë dhe të sigurtë"**

**TONILDA ÇELA**  
Njësia Lëvizëse Shkodër

Një tregues i arritjeve të përpjekjeve të Njesisë së Lëvizshme ishte fakti që një larmi e madhe aktivitete janë ndërmarrë nga vetë të rinjtë, të cilët realizuan video ndërgjegjësuese, instalacion me mesazhe (Muri i Zemrës Blu), marshim me biçikleta nëpër qytet, konkurs eseje etj.



Krahas këtyre aktiviteteve janë realizuar edhe 16 sesione informuese ku kanë marrë pjesë 332 nxënës. Duke marrë në konsideratë moshën e fëmijëve, për t'a kuptuar më thjeshtë fenomenin, trafikimi është trajtuar në forma miqësore si nëpërmjet lojës apo krijimeve artistike. Përfshirja maksimale e tyre dhe ndjeshmëria e treguar kundrejt këtij fenomeni, ka treguar se ata mund të jenë një pikë e fortë mbështetjeje për çdo bashkëmoshatar të tyre që mund të rrezikohet nga trafikimi.



**"Angazhimi i të rinjve është i rëndësishëm sepse nxit interesin i tyre për të kontribuar për kauzën dhe qasja e tyre krijon akoma më shumë impakt tek bashkëmoshatarët"**

**TAULANT GEGOLLI**  
Njësia Lëvizëse Tiranë